



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.11.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit trejavor të punës së komisionit për periudhën 25 nëntor-20 dhjetor 2019

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët (STCW) 1978”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Vasilika Hysi, Ligorag Karamelo, Rudina Hajdari, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Fatmir Velaj, Elona Hoxha dhe Eglantina Gjermani

Mungojnë:

Adnor Shameti, Halit Valteri, Reme Lala, Evis Kushi dhe Ervin Bushati

Të ftuar:

Eltar Deda – Drejtor i Përgjithshëm i Infrastrukturës në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 25.11.2019 me këtë rend dite: miratimi i kalendarit trejavor të punës së komisionit për periudhën 25 nëntor – 20 dhjetor 2019, që është edhe data e fundit e këtij sesi; shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët (STCW) 1978”, ndërkohë në mbledhjen tjetër të komisionit do të diskutojmë nën për nen projektbuxhetin e vitit 2020 për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Fillojmë me miratimin e kalendarit trejavor të punës së komisionit.

Nëse jeni dakord, zotërinj, me kalendarin, e konsideroj të miratuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët (STCW) 1978”.

Të ftuar kemi zotin Eltar Deda (ish-koleg yni), drejtor i Përgjithshëm, dhe zotërinjtë Plaku dhe Karoli. Mirë se vini, zotërinj të nderuar!

Relatore kemi zonjën Gjebrea.

Zoti Deda, fjala është për ju.

Eltar Deda – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë paraqet sot para jush projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët (STCW) 1978”.

Jemi këtu sot për të prezantuar dy amendamentet e miratuara në konferencën e Manilës në vitin 2010.

Si anëtarë të kësaj konvente, ne synojmë përforcimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e kualifikimit, të atestimit dhe të shërbimit për detarët. Konventa konsiston kryesisht në

rritjen e standardeve për trajnimin, certifikimin dhe mbajtjen nën vëzhgim të të gjitha këtyre standardeve.

Veçori e rëndësishme e kësaj konvente është se në nenin 10 të saj të gjitha shtetet joanëtare të kësaj konvente i nënshtrohen një kontrolli të rreptë në të gjitha portet ku ndalojnë anijet, por më kryesorja është që ne, si vend anëtar dhe ratifikues i kësaj konvente, i bashkëngjitemi në ndryshimet e reja të përcaktuara pikërisht në Konferencën e Manilës të vitit 2010.

Objekt i këtij projektligji është miratimi edhe nga ana e Republikës së Shqipërisë, si shtet anëtar i IMO-s, i ndryshimeve të konventës dhe i objektivave që synohet të arrihen nëpërmjet këtij projektligji, që janë si më poshtë: përmirësimi i masave për të parandaluar praktikën mashtroese që lidhen me dhënien e certifikatave të kompetencës për të forcuar procesin e vlerësimit; rishikimi i kërkesave për orët e punës dhe të pushimit dhe kërkesa të reja për parandalimin e abuzimit me drogën, alkoolin, si dhe standardet e përditësuara në lidhje me standardet e përshtatshmërisë mjekësore për detarët; kërkesa të reja në lidhje me trajnimin në teknologjinë moderne, siç janë tabelat elektronike dhe sistemet e informacionit; kërkesa të reja për trajnimin e paralajmërimit për ndotje ndaj mjedisit detar dhe për trajnimin e drejtuesve të punës në grup; kërkesa të reja të trajnimit dhe të certifikimit për oficerët elektroteknikë; përditësimi i kërkesave të kompetencës për personelin që shërben në të gjitha llojet e cisternave, duke përfshirë kërkesa të reja për personelin që shërben në cisternat me gaz të lëngët; kërkesa të reja për trajnimin e sigurisë dhe dispozitat për të siguruar se detarët janë të trajnuar siç duhet për të përballuar nëse anija e tyre bie në sulmin e piratëve; futja e metodologjisë së trajnimit modern duke përfshirë mësimin në distancë dhe trajnimin në internet (që është një nga ndryshimet e bëra në konferencën e Manilës), si dhe udhëzime të reja trajnimi për personelin që vepron në sistemin pozicionues dinamik.

Materiali dhe konventa janë voluminoze, ju i keni edhe përpara në tavolinat tuaja. Sakaq, ne jemi të hapur, si Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë, për pyetje dhe sugjerime në lidhje me këto ndryshime, të cilat ne i prezantojmë sot në komisionin tuaj.

Gjithashtu, dua të theksoj që ky projektligj është në përputhje edhe me programin e qeverisë, i cili në kapitullin “Integrimi në Bashkimin Europian” përcakton: “Zbatimi me korrektësi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), përmbushja e pjesës së mbetur nga 12 prioritetet e planit të veprimit janë elementet kryesore për cilësinë dhe shpejtësinë e procesit të aderimit të Shqipërisë në BE”.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Deda!

Fjalën e ka relatorja, zonja Gjebrea.

Elona Hoxha – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti relator dhe të gjithë të ftuarit e tjerë,

Qëllimi i projektligjit është aderimi i Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët.

Kërkesa për miratimin e këtij projektligji vjen në zbatim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë (dhe ndryshimeve të tyre), rezolutave të IMO-s për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Akti final i konventës i parashikon ndryshimet që përcaktojnë standardet, veçanërisht në fushën e ndryshimeve teknologjike; prezantojnë kriteret dhe metodologji të reja kualifikimi dhe atestimi; detajojnë kriteret e orëve të punës, të pushimit për detarët, parandalimin e abuzimit me drogë dhe alkool; përcaktojnë standardet e gjendjes shëndetësore të detarëve, si dhe synojnë të përfshijnë metodologji dhe kërkesa të reja në lidhje me trajnimin në teknologjinë moderne.

Nga miratimi i këtij akti pritet të ketë një përmirësim të ndjeshëm të standardeve kombëtare, që, në fakt, i përmendi edhe zoti Deda në fjalën e tij, për trajnimin dhe kualifikimin e marinarëve të sotëm, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare.

Dispozitat e aktit final do të jenë të detyrueshme jo vetëm për detarët, por edhe për pronarët e anijeve, institucionet e trajnimit, administratave kombëtare dhe detare.

Dëshiroj të theksoj shkurtimisht vetëm që ky projektligj që vjen sot, është në përputhje me Kushtetutën, konkretisht me nenin 121 të saj, po ashtu është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe nenin 100 të saj “Arsimi dhe trajnimi”, ku përcaktohet se palët bashkëpunojnë me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe të trajnimit profesional në Shqipëri. Pa dyshim që nëpërmjet këtij projektligji do të mundësohet zbatimi i të gjitha detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare, si dhe aderimi i Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e Manilës 2010 (*Manila Amendments 2010*), të cilat janë miratuar në konventën ndërkombëtare për standardet e kualifikimit.

Si përfundim, duke qenë se në aspektin procedural projektligji është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe, po ashtu, në aspektin formal, në përputhje me teknikën legislative, ju ftoj që ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Ka pyetje nga kolegët?

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Mirëmëngjesi, kolegë!

Faleminderit, zoti Deda dhe të nderuar kolegë, që e shoqëroni!

Unë kam dy pyetje, duke u nisur nga relacioni i projektligjit.

E para, teksti i konventës për ndryshimet ose ndryshimet e Manilës janë miratuar në vitin 2010, ndërsa ne e sjellim në parlament, pra aderimin e Republikës së Shqipërisë në këtë akt vetëm sot, pas nëntë vjetësh. A ka pasur ndonjë arsye, ndonjë pengesë pse ne nuk kemi aderuar më parë, duke pasur parasysh rëndësinë që kanë këto rezoluta shtesë, siç është mbrojtja e detit, parandalimi i praktikave mashtruese, rishikimi i kërkesave të punës dhe shumë të tjera, trajnime e me radhë?

E dyta, thoni në relacion se zbatimi i këtij projektligji do të bëhet pa shpenzime financiare, ndërkohë, në rast se shohim objektivat, që janë mbi dhjetë, të gjitha janë trjanime, kualifikime, shkurtim i orëve të punës, dhënie e pushimeve, gjë që tregon se duhen punonjës të tjerë që të punojnë, se anija kur është në det, punon non-stop, apo jo, dhe duhet të ketë staf të mjaftueshëm. Pse keni arritur në përfundimin se nuk ka nevojë për shpenzime financiare, kur kërkohet të përmirësohen një sërë aspektesh?

E fundit, më bie në sy dhe, me të drejtë, ju përcaktoni se lindin një sërë detyrash nga zbatimi i kësaj konvente. Në qoftë se ju kujtohet, ne kemi bërë disa ndryshime në Kodin Detar para dy vjetësh. Ndaj, do të desha të di, aderimi në këtë konventë, e detyron parlamentin të bëjë ndryshime në Kodin Detar, apo jo?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Jo, zoti Deda, do t'i merrni shënim të gjitha pyetjet dhe do të përgjigjeni kur t'jua jap unë lejen! Ju lutem!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Unë kam dy pyetje.

Së pari, dua të di, përdorimi i sistemit “*blue-box*” do të jetë pjesë e këtyre trajnimeve?

E dyta, ndoshta nuk ka të bëjë, dhe jam e sigurt që nuk ka të bëjë me aderimin pikërisht në këtë konferencë dhe amendimet që ju sillni, por a do të ishte e nevojshme, në gjykimin tuaj, meqenëse jemi në këtë fushë që shteti ose strukturat tuaja të mund të organizoheshin brenda një strukture, e cila do të ishte në gjendje të certifikonte mirëmbajtjen e mjeteve të lundrimit, qofshin këto private ose shtetërore? Nga informacioni që unë kam pasur që, të mund të certifikohet mirëmbajtja e mjeteve të lundrimit, kjo duhet bërë jashtë kufijve; jashtë ujërave tona. A mendoni se ka ardhur koha që ne ta kemi një kantier të tillë, që të mund të certifikojë lëvizshmërinë, nivelin teknik të mjeteve të lundrimit?

Fjala është për ju, zoti Deda.

Eltar Deda – Faleminderit!

Po u përgjigjem fillimisht pyetjeve nga zonja Hysi.

Në lidhje me pyetjen e parë: a ka pasur ndonjë vonesë që ndryshimet e konferencës së Manilës janë bërë në vitin 2010, jo, nuk është vonesë, sepse ky është një proces në vazhdimësi dhe sot, nëse ratifikohet, ne i kemi bërë edhe standardizimet, edhe certifikimet, si dhe jemi duke e mbajtur në monitorim të gjithë procesin. Ky proces kërkon kohë dhe ne e kemi sjellë në momentin e duhur, në mënyrë të tillë për ta bërë të ratifikueshme, tashmë, nga ana e parlamentit shqiptar.

Në lidhje me pyetjen e dytë: a do të ketë efekte financiare, jo, nuk do të ketë, sepse kjo bën rregullimin e orareve, gjë që ndiqet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, e cila rregullon orët e punës dhe çdolloj marrëdhënieje në aspektet që mund të prekin ndryshimet financiare. Më tej, kjo është edhe një marrëdhënie private, e cila krijohet ndërmjet kompanive që kryejnë punëdhënësi dhe punëmarrësi, që e kanë njëri me tjetrin.

Për sa u përket pyetjeve tuaja, zonja Kodheli, jo, nuk e prek këtë lloj sistemi, sepse kjo ka të bëjë me anijet e peshkimit, ndërsa ndryshimet që vijnë sot nuk e prekin fare flotën e peshkimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta më saktë mund të përgjigjet zotëria...

Thimjo Plaku – Sistemi “*blue-box*” shërben për monitorimin e anijeve të peshkimit në det. Kjo do të thotë se nuk ka të bëjë me standardet e detarëve, pra nuk preket fare. Këto janë standarde nëpërmjet të cilave certifikohen detarët që do të kryejnë punën në anije. Nuk ka lidhje fare me sistemin “*blue-box*”, nuk e prek fare këtë sistem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sistemi “blue-box” është një sistem elektronik, i cili monitoron anijet; të paktën nga njohuritë e mia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledar Karoli – Po e shpjegoj unë.

Sistemi “blue-box” është për anijet e peshkimit, të cilat nuk hyjnë në flotën tregtare, e cila trajtohet nga e gjithë kjo paketë legjislativore.

Për anijet e flotave tregtare është një sistem që quhet VTMS për monitorimin dhe informimin e anijeve, të cilin nuk e kemi ende, por sapo kemi filluar një projekt për ta instaluar me financim të Bankës Botërore.

Sistemi “blue-box” nuk është brenda sistemeve të flotave tregtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket mirëmbajtjes, ne dikur kemi pasur një kantier detar, i cili, siç e dimë, u shkatërrua, u eliminua. Kemi pasur kompani private, si Kurum-i për një periudhë që ka marrë kantierin detar, i cili u tërhoq prapë nga kjo veprimtari, ndërkohë që aktualisht nuk kemi... Herë pas here ka ndonjë paraqitje interesi për të marrë ish-kantierin detar në Durrës apo në ndonjë vend tjetër, por deri tani nuk është realizuar. Kështu që sistemi i certifikimeve bëhet jashtë. Në momentin kur mund të ngrihet një kantier detar këtu, mund të sigurohet që të certifikohen edhe brenda vendit tonë.

Mimi Kodheli – Unë do t’ju ftoja, zotërinj (sigurisht atje ku duhet dhe nëse doni mbështetjen tonë, do ta keni), që të mund ta ngrini zërin dhe të kërkonit investime që kantierit detar të mund t’i rikthehet shkëlqimi i tij i dikurshëm, pasi kjo do t’i thjeshtonte shumë procedurat dhe shpenzimet e të gjitha mjeteve të lundrimit, të cilat duhet të kalojnë në një breg tjetër për t’u mundësuar certifikimin.

Unë e kuptoj që ne nuk kemi flotën e Malit të Zi, për të mos folur për ndonjë flotë tjetër, por të mos jemi deri te flota e Malit të Zi, e cila certifikon anijet e saj dhe ato të tjerëve, sepse nuk po flasim për shtetin fqinj, Italinë, Greqinë apo Kroacinë... Kjo do t’i thjeshtonte shumë kostot dhe jetën e gjithsecujt që mbahet me këtë aktivitet. Madje, pse jo, duke ulur kostot, duke ulur kohën e certifikimit, e lundrimit për të shkuar për t’u certifikuar diku tjetër, do të mundësohej një zhvillim edhe më i mirë i këtij sektori, sigurisht kjo mbetet në gjykimin tim.

Bledar Karoli – Pa diskutim që do të ishte shumë mirë të kishim një kantier detar, sado ne vazhdimisht, aty ku kemi pasur mundësi, e kemi nxitur ngritjen e një kantieri të tillë, i cili nuk do t'i shërbente vetëm flotës sonë, që është shumë e vogël dhe nuk do ta arrinte dot efektivitetin ekonomik, por do t'u shërbente edhe flotave të tjera, duke konkurruar me koston e ulët të fuqisë së ulët punëtore. Madje, ne kemi edhe vendin që është ende disponibël në portin e Durrësit. Për vende të tjera nuk kemi pasur kërkesa. Herë pas here shfaqet ndonjë që kërkon të ngrejë një kantier. E fillon, por aty mbetet diskutimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ju faleminderit!

Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera ose diskutime nga kolegët, mendoj që t'i kalojmë këto amendime.

Shqipëria vazhdon të mbetet një vend edhe detar, edhe bregdetar. Kështu që duhet ta fuqizojmë këtë sektor dhe ta ndihmojmë sa më shumë të jetë e mundur.

E hedhim në votim në parim. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Faleminderit!

Punë të mbarë, zotërinj! Faleminderit për prezencën!

MBYLLET MBLEDHJA